

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

KOMISIONI PËR STUDIME

Ekstrakt nga Procesverbal, Dt.13.09.2021, ora 11,00

Rend Dite

1. Përgaditje rreth vitit të ri akademik 2021/22
2. Përgaditjet rreth nivelit Master (program 4+1 apo 3+2) për vitet në vijim
3. Të ndryshme.

Prezent,

1. Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi, Dekan
2. Prof.Ass.Dr. Florian Miftari, Prodekan për mësim
3. Prof.Dr. Hasim Rushit, Prodekan për shkencë
4. Prof.Dr. Bujar Turjaka, Koordinator i ECTS
5. Prof.Ass.Dr. Malsor Gjonbalaj, Mësimdhënës
6. Dr.sc. Besim Halilaj, Asistent
7. Shkëlqim Sadriu , Student
8. Drin Ferataj, Student
9. Dr.sc. Gani Ibrahimimi, Procesmbajtës

Seancën e Komisionit për Studime e udhëhoqi, Dekani, Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi, duke konstatuar se ka kuorum për procedim të pikave të rendit të dites, nga anëtarët e Komisionit për studime të zgjedhur nga Këshilli i Fakultetit
U aprovua rendi i dites.

Ad/1. Përgaditje rreth viti të ri akademi 2021/2022

Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi, dekan: Pranimi i studentëve në afatin e pare është bërë në bazë të programeve të akredituara nga AKA. Numri i të pranuarve për fat të keq është zvogluar nga 150 në 100 , ndërsa i atyre që kërkojnë të pranohen është rritur.

Vende vakante janë mbetur vetëm për minoritete dhe atyre që vijnë jashtë Kosovës, që besoj të plotësohen në afatin e dytë. Në konkursin plotësuse janë vetem edhe 15 vende.

Ne duhet respektuar numrin e të pranuarve, tani të kufizuar sipas programeve të akredituara.

Përgaditjet janë bërë për fillim vitin akademik 2021/2022.

Të përshtatemi në respektimin e masave anti-covid.

Drin Ferataj-student: A duhet, dhe a është obligative që minoritetet të dijnë gjuhën shqipe.

Prof.Asoc.Dr. Musa Serlimi, Dekan: Gjuha është kriter dhe e domosdoshme të njifet, jo vetëm sa për konkurrim por edhe në provime.

Prof.Dr. Hasim Rushiti Prodekan për shkencë: Minoritetet dhe ata që vijnë jashtë Kosovës duhet që të integrohen dhe të inkurajohen që ta mësojnë gjuhën shqipe sepse është gjuhë zyrtare për studim dhe komunikim në FEFS.





Ad/2. Përgaditjet rreth nivelit Master (program 4+1 apo 3+2) për vitet në vijim

Prof.Ass.Dr.Florian Miftari, Prodekan për mësim; Ne tani e kemi publike për akreditimin e programit Bachelor 4 vjeçar, apo (mos) ri-akreditimit të programit Master 2 vjeçar, që mendoj se na është dëmtuar procesi jo vetëm i mësimdhënësve që janë nëpër shkolla e që kanë të përfunduar vetem programin Bachelor tre vjeçar e që kanë pas shumë nevojë sepse i detyron Udhëzimi administrative për 300 ECTS.

Me, 2 Prill 2022, është data që duhet të dërgojmë programet e reja për akreditim-Bachelor. Ne kemi hartuar një projekt, lidhur me hartimin dhe hulumtimin e tregut të punes. Andaj kjo do të jetë një ndihmesë shumë e madhe.

Propozimet, apo ndryshimet elementare tek programet e reja duhet të shkojnë kah: Nutricioni, Edukimi fizik, Përgaditjet fizike, Shëndet dhe turizëm, Për trajnerë, Për Media dhe gazetari etj. Propozoj që programi i ri të jetë inovativ, me 5 vjeçar studime (3+2). Me kredi të mjaftueshme për Edukim Fizik shëndet dhe Rekreacion.

Drin Ferataj-student; Unë mendoj që, më mire të ndahen programet, e jo si të integruara. Më mire të nahen në 3 +2 dhe të orjentohej kush don arsimtar e kush diqka tjetër që dëshiron të studjoj.

Prof.Asoc.Dr.Musa Selimi, Dekan: Programet me studimet 5 vjeçare në vazhdimsi, dmth në vitin e katërt të ndahen në drejtime të ndryshme: Fitnes, Rekreacion, Menaxhment, Mjekësi sportive etj.

Prof.Ass.Dr.Florian Miftari,Prodekan për mësim; Tregu i punes dhe vetë hulumtimet që kemi berë të jepin me kuptu drejtimet e kërkura dhe që janë në trend.

Ne duhet të fuzionojmë masterin 2 vjeçarin në 1 vjeçar, sepse ky ekzistuesi Bch është akredituar për një periudhë katër vjeçare.

Prof.Dr. Hasim Rushiti Prodekan për shkencë: Programet për Edukim fizik dhe Kondicional.

Shkëlqim Sadriu, Student: Unë mendoj për dy programe: për Shkencë dhe arsim e dukim të jenë 4 vjeçare. Deri në vitin 2021 ata që skan pas 240 ECTS, duhet të diplomojnë. Edhe pse tregu po shkon kah 3 vjeçari, kah fitnesi, kah rekreacioni, kah nutricioni.

Prof.Ass.Dr. Florian Miftari, Prodekan për mësim: Ne duhet të punojmë për:

- Një RVV shumë e përgaditur,
- Një Program të ri në vitin 2022
- Një program tu fuzionuar nga 2 vjeçar në 1 vjeçar,
- Një program të ri Bachelor të integruar 3+2.

Në bazë të Statutit të UP-së, lejohet përshtatja e programeve të akredituara

Lëvizjet e lëndëve të bëhen vetëm lëvderdi të studentëve dhe cilësisë së programeve.

- Metodologjia kërkimore të mbete aty ku është në vitin e tretë,
- Skijimi të dal në semestrin e dytë,
- Nutricioni të dal në semestrin e dytë



Prof.Dr. Bujar Turjaka, Koordinator i ECTS; Ne duhet të marrim edhe përvojat e Univeriteteve në rajon, por gjithëherë duke hulumtuar edhe tregun se çka duhet të prodhojmë. Të rrisim mobilitetin e studentëve dhe ngjashmërinë e programeve me Universitetet Evropiane e më gjerë.

Ad/3. Të ndryshme.

Në pikën në të ndryshme nuk pati diskutime pasi konstatuan se u shteren paraprakisht. Pasi u shteren të gjitha pikat e rendit të dites, Dekani mbylli seancën në ora 12, e 30 min.

Procesmbajtësi
Sekretari, G.Ibrahimi

G. Ibrahimi

